



Pranuar / Dorezuar Pritjenor / Prodator Received / Delivery	23.01	3	viti god year
Organ / Njesia Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTICK	680/2023		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1115/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1115/2022 të datës 08.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafin 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.01.2023, njëzëri, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1115/2022 të datës 08.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit, sipas Akt emërimit të datës 01.04.2011 në pozitën "Inspektor i Trafikut", në Drejtoratin për Inspektorat.

Me datën 24.11.2022 përmes shkresës me numër 1-120/04-63306, i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Personelit në Komunën e Lipjanit, lidhur me harmonizimin-ndryshimin e koeficientit nga gjashtë (6) në tetë (8) si dhe kompensimin retroaktiv të pagës nga muaji vijues, ndërsa për periodën në të cilën është dëmtuar pa qenë i informuar ka kërkuar që në mënyrë retroaktive të kompensohet për pjesën e humbur të pagës. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore të kësaj komune me datën 30.11.2022 përmes përgjigjes në kërkesë me numër 1-120/04-63306, është përgjigjur në atë drejtim duke theksuar faktin se kjo komunë përkundër kërkesave të datës 14.10.2022 dhe 22.11.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientëve drejtuar DMZP-së nuk kanë

marrë ndonjë përgjigje, pozitive, si dhe kanë njoftuar po ashtu se nuk kanë qenë të njoftuar se ekziston shkresa Nr.DASHC-MAP/04/1571 02/ZPS/3851 e datës 20.11.2014.

I pakënaqur me përgjigjen e Komunës së Lipjanit konkretisht Zyrës së Burimeve Njerëzore, me datën 08.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7763/2022 për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale, dispozitave procedurale dhe diskriminimit në shpërblim të pagës komfor kategorisë, nivelit profesional dhe gradës. I njëjti kërkon harmonizimin e koeficientit nga gjashtë (6) në tetë (8) si dhe kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive sipas kërkesës së datës 24.11.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7991/2022 në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datën 27.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 8474/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga Komuna e Lipjanit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7763/2022 të datës 08.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.04.2011; Kërkesën me numër të protokollit 1-120/04-63306 të datës 24.11.2022 të parashtruar nga ankuesi tek Komuna e Lipjanit; Përgjigjen në kërkesën e ankuesit me numër 1-120/04-63306 të datës 30.11.2022 nga Zyra e Personelit në Komunën e Lipjanit; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 13.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 27.12.2022 nga Komuna e Lipjanit lidhur me provat e bashkëngjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 09.10.2012.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshirë edhe koeficientët dhe nivelet e koeficientëve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar së gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficientëve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marrë parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese, kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Siç u theksua me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër, A.nr.1115/2022.

Ardita Perçuku-SHYTI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

